



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e III-të

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja nr. 31
Prishtinë, më 8.09.2009
Salla N-225 ora 11,00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Gani Buçinca, Adem Hajdaraj, Arsim Rexhepi, Donika Kadaj-Bujupi, Heset Cakolli, Memli Krasniqi dhe Dragan Dimiq
Munguan: Mark Krasniqi dhe Enis Kervan.

Nga sekretaria e Kuvendit mori pjesë: Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu

Në mbledhje prezantuan përfaqësuesit e OSBE-së, NDI-së, përfaqësuesi nga presidenca dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Mbledhjen e udhëhoqi: **Agim Veliu**, kryetar i Komisionit.
Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
- 2. Shqyrtimi i amendamenteve të Projektligjit për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë.**
- 3. Të ndryshme.**

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

Agim Veliu -kryetar, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryetari i Komisionit- konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së datës 14.07.2009.

2. Shqyrtimi i amendamenteve të Projektligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë.

Agim Veliu -kryetar, theksoi se Komisioni në mbledhjen e datës 14.07.2009 ka shqyrtuar dhe ka miratuar raportin me rekomandime të Projektligjit për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë dhe i njëjti është proceduar Komisioneve kryesore për shqyrtim. Komisionet kryesore pas shqyrtimit të Raportit me rekomandime të Komisionit funksional nuk kanë propozuar ndonjë amendament dhe e kanë miratuar si tillë. Ky Projektligj ka për qëllim avancimin dhe riafirmimin e vazhdueshëm të pjesëmarrjes së të rinjve në procesin vendimmarrjes, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së jetës së të rinjve dhe të statusit të tyre shoqëror.

Kryetari – konstatoi se Raporti me Rekomandime në Projektligjin për Fuqizimin e rinisë të Komisionit do të procedohet për miratim në njërën nga Seancat e Kuvendit. Ky vendim u miratua me shumicë votash nga anëtarët e Komisionit.

Memli Krasniqi – theksoi se neni 3.1, i Projektligjit për Fuqizimin e rinisë duhet të ndryshojë. Grup -mosha 15 deri 24 vjeçare paraqet diskrepancë me realitetin e angazhimeve rinore në Kosovës. Ai tha se mosha 15 vjeçare nuk mund të konsiderohet si moshë e re sepse Konventat Ndërkombëtare e parashohin këtë deri në moshën 18 vjeçare. Propozoi që grup-mosha e të rinjve të jetë prej moshës 18 deri 30 vj. Ai tha se këtë propozim amendament do ta paraqes në Seancë Plenare. Ky propozim i amendamentit nuk u përkrah nga anëtarët e Komisionit. **Kryesuesi** theksoi se anëtarët e komisionit apo deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë të drejtë të dalin me propozime të tyre.

3. Të ndryshme

Anëtarët e Komisionit debatuan për çështjen e testit të maturës shtetërore , për çështjen e akreditimit të IPAL-së si dhe për rritjen e numrit të studentëve në UP të Prishtinës.

Kryesuesi – theksoi se sa i përket çështjes së testit të maturës shtetërore për vitin 2009, si Komision duhet të kërkojmë nga MASHT-i që të ofrojë Raport me informacione më detajuese dhe më pas mund të marrim iniciativë për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Maturën.

Anëtarët e komisionit diskutuan edhe për çështjen e uljes së kriterit të kalueshmërisë së provimit të maturës shtetërore.

Kryesuesi konstatoi se këto çështje mund të debatohen në mbledhjen e radhës së Komisionit.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 12.

***Kryetar i Komisionit,
Agim Veliu***